



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 30.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "EFA DIENSTLEISTUBG GMBH –DEGA NE KOSOVE", për aktivitetin: "Pastrimi i objekteve të QMF-ve" Nr. të Prok: 616 20 1939 211 nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "EFA DIENSTLEISTUBG GMBH –DEGA NE KOSOVE" e datës 21.09.2020.

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë aktivitetin sipas publikimit të datës 14.09.2020.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori ekonomik nuk ka ngarkuar në E prokurim kerkese të kompletuar, por ka ngarkuar vetëm Njoftimin për kontratë, për arsye që në nuk mund të dijme. Nëse keni dëshmi për ngarkim të dokumenteve për arsye të mospranimit të tyre kërkoni sqarime në Help Desku të KRPP-se dhe çfaredo dëshmie eventuale nëse dëshironi të vazhdoni me ankesë ju shërben si dëshmi në atë fazë.

**Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.**

**Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.**

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, nese ka deshmi dhe argumente lidhur me kerkesen e vet ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit